

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar	07 03	08	
Nj. Org	Numër	Shënim	Vlera
01-400/01-	10495		

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA GLLOGOC / KOMUNITETI GLLOGOC / MUNICIPALITY OF GLLOGOC / SKUPSTINA OPSTINA
SHËNIMET

Nr. 02-343/01-0010286/22
07-03-2022



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit dhe Skenderajt



MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT NDËR KOMUNAL

Palët nënshkruese të marrëveshjes

Komuna e Drenasit dhe Komuna e Skenderajt

Kanë rënë dakord mbi arritjen e Marrëveshjes së bashkëpunimit ndër komunal në fushën e Infrastrukturës rrugore.

DUKE KONSIDERUAR që bashkëpunimi në fushën e ofrimit të shërbimeve në fushën e infrastrukturës rrugore është i një rëndësie të veçantë.

DUKE PRANUAR që pjesëmarrja në një aktivitet të tillë është vullnetare dhe që përfshinë bashkëpunim ndër komunal dypalësh (ose shumë palësh nëse ka më shumë palë në marrëveshje) mbi baza të drejta.

DUKE JU REFERUAR Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 neni 17 (k) dhe 30, Ligji për Bashkëpunimin Ndër komunal Nr. 04/L-010, Ligji për Arbitrazhin Nr. 02/L-75.

Neni 1 BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje bashkëpunimi mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 neni 17(k) dhe 30, Ligji për Bashkëpunimin Ndër komunal Nr. 04/L-010 Ligji për Arbitrazhin Nr. 02/L-75.

[Signature]

[Signature]

Neni 2
QËLLIMI

Qëllimi i bashkëpunimit është që të përmirësohet infrastruktura rrugore në territoret e dy komunave si rezultat i këtij bashkëpunimi, e me qëllim të rritjes së mirëqenies së qytetareve të komunave përkatëse, rrjedhimisht interesin e përbashkët lokal.

Qëllimi i marrëveshjes është që të definohen qartë caqet, objektivat dhe përgjegjësitë përkatëse të secilit organ veç e veç .

Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimi të dyanshëm.

Neni 3
LËNDA E MARRËVESHJES

Lënda e kësaj marrëveshje është përcaktimi i obligimeve dhe mënyra e financimit me qëllim të realizimit të projektit në fushën e infrastrukturës rrugore.

Neni 4


TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SECILËS PALË TË PËRFSHIRË NË MARRËVESHJE

Të drejtat dhe detyrimet e Komunës së Drenasit

1. Zhvillimi i procedurave të prokurimit
2. Sigurimi i dokumentacioneve të nevojshme
3. Sigurimi i mjeteve për bashkëfinancim

Të drejtat dhe detyrimet e Komunës së Skenderajt

1. Sigurimi i dokumentacioneve të nevojshme
2. Sigurimi i mjeteve për bashkëfinancim
3. Qasje në të gjitha procedurat në kuadër të këtij projekti



Neni 5
BURIMET E FINANCIMIT

Përmes grandit të UN-Habitati Kosoves, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe me bashkëfinancimin nga buxhetet e Komunave përkatëse.

Neni 6
KOORDINIMI NDËRMJET PALËVE

Palët në këtë marrëveshje janë pajtuar për formimin e grupit të përbashkët punues për zbatimin e kësaj marrëveshje.

Neni 7
ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

1. Ç'do mosmarrëveshje mbi interpretimin, menaxhimin ose ekzekutimin e kësaj marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim, arbitrazh dhe përmes gjykatës kompetente.

Neni 8
HYRJA NË FUQI

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit ndër komunal hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

Kjo marrëveshje është hartuar në katër (4) kopje origjinale, ku palët nënshkruese marrin nga dy (2) kopje.


Komuna e Drenasit
Ramiz Lladrovci




Komuna e Skenderajt
Fadil Nura

Date: 24.02.2022